



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRI I FINANCEVE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E THESARIT

Nr. Prot.

Tirane, me

2008

URDHER

Nr. 67 Date 19.04.2008

PER SHPALLJEN DHE ZBATIMIN E DETYRUESHEM TE
STANDARDEVE NDERKOMBETARE TE KONTABILITETIT DHE TE
RAPORTIMIT FINANCIAR, TE PERKTHYERA NE GJUHEN SHQIPE.

Ne mbeshtetje te nenit 4 te Ligjit nr. 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" te ndryshuar me Ligjin nr. 9477 date 09.02.2006, ne vendimin nr. 1 date 19.04.2008 te Keshillit Kombetar te Kontabilitetit derguar me shkresen nr. 45 date 25.04.2008 ;

URDHEROJ :

1. Shpalljen e Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit (SNK) dhe te Raportimit Financiar (SNRF), te perkthyer ne gjuhen shqipe nga Kompania angleze IMCL, nen pergjegjesine e Keshillit Kombetar te Kontabilitetit, pa ndryshime nga teksti origjinal ne gjuhen angleze, sipas materialeve perkatese ngjitur.
2. Standardet Nderkombetare te Kontabilitetit dhe te Raportimit Financiar behen te detyrueshme per zbatim nga data 1 Janar 2008.
3. Per zbatimin sa me te mire te tyre, me perdoruesit e standardeve, te organizohen seminare dhe trajnime te vazhdueshme, nga te gjitha palet e interesit.
4. Standardet nderkombetare te kontabilitetit dhe te raportimit financiar te publikohen ne faqen e Internetit te Ministrise se Financeve dhe te Keshillit Kombetar te Kontabilitetit.
5. Keshilli Kombetar i Kontabilitetit te organizoje punen per botimin dhe perditesimin e standardeve nderkombetare te kontabilitetit dhe te raportimit financiar, ne perputhje me detyrimet qe rrjedhin nga Marrveshja e lidhur per kete qellim, midis Ministrise se Financeve te Shqiperise dhe Bordit te Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit(IASCF) ne Londer..

Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere dhe i shtrin efektet nga data 01 Janar 2008.

